



SHPALLJE

Thirrje për të Ofertuar për Shërbime të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të FKGK-së

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) synon të sigurojë shërbime të auditimit të jashtëm për Pasqyrat Financiare të FKGK-së për një periudhë tre (3) vjeçare. FKGK ka përgatitur një Kërkesë për Propozim (KPP) për shërbimet e kërkuara dhe fton të gjithë ofertuesit e kualifikuar për t'iu përgjigjur KPP-së.

Propozuesi duhet të demonstrojnë qartë se i plotëson kriteret e detyrueshme si në vijim:

- Propozuesi duhet të jetë i licencuar në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin dhe të jetë i autorizuar të ofrojë shërbime të auditimit të pasqyrave financiare në Kosovë;
- Propozuesi duhet të ketë: (a) së paku dy (2) partnerë kyç të auditimit përgjegjës për Kosovën, auditues ligjor të certifikuar nga një shoqatë e kontabilistëve dhe auditorëve e Kosovës e anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), ShKÇAK dhe (b) së paku një anëtar i ekipit të auditimit, të ketë kualifikim profesional ndërkombëtar të auditimit të jashtëm (ACCA).
- Propozuesi duhet të ketë përvojë së paku tri (3) vjeçare në kryerjen e auditimeve të pasqyrave financiare, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të bankave dhe/ose institucioneve mikrofinanciare dhe të ofrojë dëshmi të auditimeve paraprake;
- Propozuesi nuk duhet të ketë ofruar shërbim auditimi në FKGK në tre (3) vitet e mëparshme dhe nuk është në bazë të kontratës ose nuk është në negociata për të bërë këtë;

Mos përmbushja e kriterëve të mësipërme nga propozuesi, do të rezultojë në përjashtim nga shqyrtimi i mëtejshëm, gjatë procesit të vlerësimit.

Ofertuesit e interesuar që përmbushin kriteret, ftohen të paraqesin propozimet e tyre dhe të gjithë dokumentacionin përkatës për implementimin e detyrës sipas udhëzimeve të përcaktuara në KPP. FKGK nuk do të jetë përgjegjës për cilëndo kosto që lidhet me përgatitjen ose dorëzimin e ofertave.

Afatet janë si më poshtë:

- Afati i fundit për të kërkuar RFP: **31 Korrik 2025 në orën 15:00**
- Afati i paraqitjes së pyetjeve: **4 Gusht 2025 në ora 15:00**
- Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve: **12 Gusht 2025 në ora 15:00**

KPP mund të kërkohej vetëm duke dërguar një email tek procurement@fondikgk.org. Kërkesa e emailit duhet të përfshijë:

- Emri i kompanisë, adresa zyrtare e regjistruar, numri i telefonit, adresa e postës elektronike dhe faqja e internetit.
- Emri i personit të caktuar të kontaktit / ndërlidhës për KPP-në në kompani, titullin, adresën e emailit dhe numrin e telefonit.
- Adresa e postës elektronike në të cilën duhet të dërgohet KPP-ja nëse është e ndryshme nga ajo e personit kontaktues / ndërlidhës.